



K.DH.SH.II.nr.1596/23

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija Ymeri, kryetare e kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Faton Bajrami, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Doni Fruits” Sh.p.k me seli në Ferizaj, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “SCRL Partners” me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Manushaqe Bytyqi, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.294/22, të datës 21.02.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 05.04.2024, merr këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**Refuzohet** si e pa bazuar ankesa e të paditurës Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë e datës 04.05.2023, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.294/22, të datës 21.02.2023, **vërtetohet**.

### **A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Administrative me aktgjykimin e ankimuar, nën pikën I. të dispozitivit, Aprovohet në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit “Doni Fruits” Sh.p.k, nën pikën II. Anullohet vendimi nr.8932 i datës 28.12.2018 i nxjerrë nga i padituri Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe çështja i kthehet të paditurit në rishqyrtim dhe rivendosje. Në pikën III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar i autorizuari i të paditurit, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të drejtë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të pranohet ankesa e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë në Kuadër të Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në tërësi si e bazuar, të prishet aktgjykimi KA.nr.294/22.

Përfaqësuesi i paditësi ka paraqitur përgjigje në padi, duke thekuar se ankesa e palës së paditur e ushtruar ndaj aktgjykimit të Gjykatës së Shkallës së Parë është krejtësisht jo i bazuar pasi që Dhoma e Shkallës së Parë ka vendosur në përputhshmëri të plotë me dispozitat ligjore të cilat e rregullojnë këtë fushë. Andaj kërkojmë nga Dhoma e Shkallës së Dytë që ta refuzojë si të pa bazuar ankesën e ushtruar kundër aktgjykimit KA.nr.294/22 të datës 21.02.2023 të Gjykatës Komerciale në Prishtinë, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Administrative dhe të vërtetohet aktgjykimi KA.nr.294/22 i datës 21.02.2023 i Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, sipas të cilit aktgjykim është aprovuar si e bazuar kërkesëpadija e paditësit, është anuluar vendimi i të paditurës dhe lënda është kthyer përsëri në rishqyrtim dhe rivendosje pranë të paditurës.

Dhoma e Shkallës së Dytë shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 49, të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), dhe neni 194 i LPK-së, ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjen se;

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura me vendimin me nr.8932 të datës 28.12.2018 është refuzuar ankesa si e pa bazuar e Sh.p.k “Doni Fruits”-H.A.- nga Komuna Ferizaj e datës 20.12.2018.

Paditësi, i pa kënaqur me këtë vendim ka ushtruar padi në Gjykatë me datë 01.02.2019, kundër të paditurit MBPZHR-AZHB në Prishtinë, duke pretenduar se vendimi i tij është jo ligjor. Dhoma e Shkallës së Parë, për këtë çështje mban seancë të shqyrtimit kryesor, me datë 13.02.2023, në prani të përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse dhe pas administrimit të provave si dhe shkresave tjera të lëndës bien aktgjykimin e ankimuar me të cilin e aprovon kërkesëpadinë e paditësit, si të bazuar, me arsytim se nga provat e administruara ka rezultuar se i padituri nuk ka vepruar drejtë kur ka refuzuar ankesën e paditësit dhe ka vërtetuar vendimin e shkallës së parë me të cilin

paditësit i është refuzuar kërkesa për përkrahje publike në masën 103.3 përpunimi i pemëve dhe perimeve. Për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të goditur, gjykata iu referua nenit 8 par.2 të Ligjit nr.04/L-090 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural dhe të nenit 15 të UA nr. 05/2018 që përcakton kushtet lidhur me masën 103.3 (Sektori për Përpunimin e Pemëve dhe Perimeve) ashtu që në pikën 1.1 është përcaktuar se “Aplikuesit duhet të jenë të regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK) me aktivitetin përkatës së paku dy vite para datës së aplikimit dhe i regjistruar në AUV së paku 2 vite para datës së aplikimit”. Lidhur me këtë gjykata iu referua kriterëve të Sektorëve tjerë siç, është rasti me sektorin e prodhimit të verës nga neni 16 i UA nr.05/2018 i cili në mënyrë të qartë përcakton si kriter përvojën prej së paku 2 viteve para datës së aplikimit, pra në këtë rast UA nr. 05/2018 ka bërë përcaktimin e qartë të termeve të përdorura tek kriteret dhe në asnjë rast nuk mund të interpretohet kriteri i regjistrimit si kriter i përvojës pasi që varësisht nga Sektori i përkrahjes është përcaktuar nëse është i nevojshëm vetëm regjistrimi apo edhe përvoja për periudhën e caktuar. Andaj në këtë rast është përcaktuar si kriter vetëm regjistrimi prej së paku 2 viteve para datës së aplikimit kriteret të cilat paditësi i ka plotësuar pasi që është regjistruar në ARBK me datë 29.10.2014 dhe në AUV me datë 20.04.2016. Në këtë drejtim gjykata e obligon të paditurin në kuptim të nenit 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative që në afat prej tridhjetë (30) ditësh, në ri procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi ti mënjanoj të metat e cekura lidhur me zbatimin e kriterit të regjistrimit në vend të kriterit të përvojës të merr vendim të drejtë e të bazuar në ligj, me të cilin do të njoftohen palët me kohë.

Qëndrimin juridik të Dhomës së Shkallës së Parë, kolegji e vërteton si të drejtë dhe të ligjshëm pasi që i njëjti është i bazuar në prova dhe ligj, në tërësi e aprovon, se aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje Dhoma e Shkallës së Dytë i vlerëson sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së, ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA-së. Kolegji vlerëson se Dhoma e Shkallës së Parë sipas kompetencës si në vështrim të nenit 9 dhe 44 të LKA-së, në mënyrë të drejtë ka shqyrtuar dhe vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të paditurës të ankimuar me padi, i cili vendim i ka të përmbledhura argumentet në të cilat është bazuar në arsyetimin e tij, ku janë dhënë arsye të mjaftueshme mbi faktet vendimtare në të cilat është bazuar, e të cilat Dhoma e Shkallës së Dytë, njëjtë si Dhoma e Shkallës së Parë i miraton si të drejta dhe ligjore.

Kolegji gjen se bazuar në provat e administruara nga Dhoma e Shkallës së Parë, është vendosur drejt dhe janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për faktet vendimtare dhe bazat ligjore në të cilat bazohet aktgjykimi për aprovimin e kërkesë padisë së paditëses, sepse pa dyshim vërtetohet se, paditësi ka plotësuar kriteret për të qenë përfitues i përkrahjes publike në masën 103.3, pasi që në këtë masë nuk është kërkuar përvojë paraprake në fushën përkatëse mirëpo vetëm regjistrimi në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës dhe Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinë për dy vite para datës së aplikimit. Andaj, Dhoma e Shkallës së Dytë ka vërtetuar se e paditura nuk ka vepruar drejtë me rastin e refuzimit të kërkesës së paditësit për përkrahje publike në masën 103.3 përpunimi i pemëve dhe perimeve.

Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë me administrimin e provave në këtë aktgjykim ka bërë konstatim të gabuar dhe jo të drejtë të gjendjes faktike pasi që e njëjta nuk i ka trajtuar të gjitha provat veç e veç, Kolegji i kësaj gjykate këto pretendime ankimore nuk i aprovoi, për faktin se Dhoma e Shkallës së Parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e të paditurës janë të pa bazuara, ngase të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës. Ndërsa sa i përket pretendimeve se Gjykata e Shkallës së Parë duke interpretuar dispozitën ligjore të nenit 15 të UA nr.05/2018 ka bërë zbatim të gabuar të së drejtës materiale, pasi që nuk ka bërë vlerësim të tërësishëm të masës 103 e cila fillon me kriteret e përbashkëta të pranueshmërisë duke filluar kreu i IV- masa 103-Investimet në asetet fizike e në përpunimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqësore, pra qysh në fillim definohet se vetëm ndërmarrjet përpunuese mund të jenë përfitues në këtë masë por ka interpretuar vetëm në mënyrë të shkoqitur vetëm kriteret e veçanta për nën masën 103.3 përpunim për pemë dhe perime. Kolegji konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës, sepse Dhoma e Shkallës së Parë nuk ka gjetur dëshmi që do të mund të vërtetonte një gjendje tjetër faktike, për arsye se e paditura nuk ka ofruar prova të bazuara që do të ndryshonin gjendjen faktike të vërtetuar nga Dhoma e Shkallës së Parë. Andaj, sipas vlerësimit të kolegjit, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, ngase nuk është shkelur ligji material në dëm të paditurës.

Dhoma e Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm një konkludim të tillë juridik të Dhomës së Shkallës së Parë, andaj kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë dhe drejtë ka zbatuar ligjin kur e anulon vendimin e atakuar me padi, sepse i njëjti nuk është i plotë dhe përmbajtjesorë për tu vlerësuar ligjshmëria e tij si në vështrim të nenit 9 të LKA-së, dhe se i njëjti përmban të meta esenciale. Organi i paditur është dashtë që pas shqyrtimit të ankesës së paditësit të nxjerr aktvendim përmbajtjesorë, ashtu si parashihet me nenet 84, 85 dhe 86 të LPA-së, i cili aktvendim do të duhej ti kishte në përmbajtjen e tij përmbledhjet faktike, bazën ligjore në të cilat bazohet akti, po ashtu nuk ka zhvilluar as edhe procedurën e administrimit të provave, në arsyetim mbi bazën e të cilave kish mundur të arsyetoj pretendimet e kërkesës për përkrahje publike në masën 103.3 përpunimi i pemëve dhe perimeve pa u shtjelluar çështja në mënyrë të argumentuar dhe bindëse.

Mbi këtë gjendje të fakteve për shkak të metave të cekura si më lartë është anuluar Vendimi i të paditurit, dhe është obliguar në ri procedurë të veprj si në vështrim të nenit 65 të LKA-së, që pas administrimit të provave të nevojshme, e duke ju përmbajtur edhe vërejtjeve dhe sugjerimeve të gjykatës, të vendos në këtë çështje juridike, me vendim përmbajtjesor ashtu si parashihet me dispozitat e LPA-së, dhe ligjit material.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë**

K.DH.SH.II.nr.1596/23, me datë 05.04.2024

Kryetare kolegjit,  
Franciska Zhitija Ymeri